

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, të zbatueshëm sipas Rregullores së PSSP të KB nr. 2003/30, nenit 3 al. 1 pika b, të Rregullores për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nr. 2000/45, nenit 19 alineja 1 pika 2 dhe nenit 39 alineja 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 nëntor 2006, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban për një pjesë të lokacionit "Lakuriqi" për "Kvadratin F6. 2b" të qytetit të Prizrenit

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRrU-së për një pjesë të lokacionit "Lakuriqi" për "Kvadratin F6. 2b" të qytetit të Prizrenit, që është ofruar si donacion nga grupi i donatorëve të përfaqësuar nga Arsim Emimi nga KK Sharr (Dragashi), të hartuar nga NTSh Studio Projektuese "Diarko" nga Prizreni (bartës i hartimit të planit), e hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi për miratimin e PRrU do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- Kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike do të përmbajë:

- Paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2

Me Planin Rregullues Urban, për një pjesë të lokacionit "Lakuriqi" për "Kvadratin F6. 2b" të qytetit të Prizrenit, përfshihen ngastrat kadastrorë: nr. 139/1, 139/2, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 164, 165, 166, 167, 168, 168/1, 168/2, 168/3, 169, 1038/2, 1038/3, 1038/4, 1038/5, 1038/6, 1038/8, 1038/9, 1038/10, 1038/11, 1038/12, 1038/13, 1038/14, 1038/15, 1038/16, 1038/17, 1038/18, 1038/19, 1038/20 dhe 1038/21, gjithsej në sipërfaqe prej $S=14.311 \text{ m}^2$ dhe parashihet ndërtimi i banimit kolektiv me afarizëm, tregti, administratë, biznes dhe banim.

Neni 3

Plani Rregullues Urban për një pjesë të "Lakuriqit" për "Kvadratin F6. 2b" të qytetit të Prizrenit" përfshin lokacionin që kufizohet me rrugët: "Zahir Pajaziti", "Xhemë Gostivari", "Paqja" dhe rrugën "Ardianët".

Neni 4

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi është i planifikuar rregullimi i hapësirës në pajtim me Planin Zhvillimor Urban që bazohet me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të qytetit të Prizrenit, me qëllim që t'ua mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim urban dhe kushte të sigurta të investimit.

Neni 5

Plani Rregullues Urban do të vlejë për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 6

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, al. 2 të këtij Vendimi, do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Çështjeve Pronësore-Juridike dhe Drejtoria e Gjeodezisë e Kadastrës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".


KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Asambleja Komunale

Nr 01/011-60

Më 23 nëntor 2006

Prizren



Kryetari i Kuvendit
Mr. Edrem Kryeziu